



Figura 7 Perceptimet e korrupsionit mbi zyrtarët publik – ndryshimi i perceptimit midis vitit 2014 dhe 2016




4/5 e shqiptarëve (78 %) e konsiderojnë presionin e korrupsionit si “shumë të mundshëm” dhe “të mundshëm”, ndërsa vetëm 22% e tyre e konsiderojnë presionin e korrupsionit si “aspak të mundshëm”. Kjo do të thotë se qytetarët besojnë se në çfarëdo ndërvëprimi që mund të kenë me zyrtarët publikë, ata do të jenë subjekt i presionit korruptiv prej këtyre të fundit për t'u bërë pjesë e praktikave korruptive.

Figura 8 Perceptimet mbi mundësinë për korrupsion (%)



3/4 e të anketuarve (76%) thanë se “Korrupsioni nuk mund të reduktohet ndjeshëm”, ndërkohë që pak më shumë se 1/5 e tyre (22%) mendojnë se “Korrupsioni mund të reduktohet ndjeshëm ose të çrrënjoset”. Edhe pesha specifike e qytetarëve, që mendojnë se korrupsioni mund të reduktohet ndjeshëm ose të zhduket, ka ardhur në rënie në krahasim me matjet e kryera në vitet 2001, 2002 dhe 2014.

Figura 9 Perceptimet mbi realizueshmërinë e politikave kundër korrupsionit (%)




Studimi i Monitorimit të Korrupsionit është kryer në fillim të vitit 2016 në nëntë vende, përfshirë Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi, Serbinë dhe Turqinë në kuadër të LiderShipit të Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet (SELDI).

SELDI është rrjeti i shoqërisë civile më i madh për anti-korrupsionin dhe mirëqeverisjen në Evropën Juglindore. Në fillimin e tij ai mbledhi 17 partnerë nga 9 vende të Evropës Juglindore. SELDI punon për të forcuar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në gjetjen e zgjidhjeve të reja të partneritetit publik-privat për sfidat e qeverisjes dhe korrupsionit në rajon.



Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), e themeluar në vitin 1993, kryen shërbime këshilluese dhe hulumtuese për çështjet socio-ekonomike në vend, duke kërkuar për të promovuar vlerat e integritetit ekonomik, demokracisë, mirëqeverisjes dhe forcimin e sektorit joqeveritar.

 Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajta e këtij dokumenti është përgjegjësi e iniciativës së SELDI-it dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si pikëpamje të Bashkimit Evropian.

GJETJET KRYESORE: SISTEMI I MONITORIMIT TË KORRUPSIONIT (SMK)

SHQIPËRI 2016



HYRJE

Kjo fletëpalosje paraqet rezultatet dhe gjetjet e një studimi kombëtar mbi perceptimin e korrupsionit, qëndrimet dhe përvojat, të kryer në periudhën Janar-Shkurt 2016. ACER zhvilloi studimin dhe e bazoi atë në metodologjinë e Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit e cila ishte përdorur për tre studime kombëtare të ngjashme në vitin 2001, 2002 dhe 2014 në nëntë vende të Evropës Juglindore nën kuadrin e SELDI-t. Pavarësisht boshllëkut të madh në vite, rezultatet lejojnë për një vlerësim në dinamikën dhe tendencat e treguesve kryesorë të korrupsionit.

METODOLOGJIA


Studimi është realizuar në nivel kombëtar me një kampion prej 1000 të anketuarish të moshës 18 dhe më lart, përmes intervistave ballë për ballë.

Tre koncepte dhe terma të ndryshëm janë përdorur si indikatorët kryesorë të Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit (SMK) për të përshkruar fenomenin e korrupsionit: eksperiencën, qëndrimet dhe perceptimet. Si definicion, korrupsioni administrativ përfshin përvetësimet (para, dhurata, favore, etj.) nga qytetarët, në këmbim të marrjes së shërbimeve nga ana e zyrtarëve publik.

EKSPERIENCA ME KORRUPSIONIN

Të anketuarit janë pyetur në lidhje me eksperiencat që ato kanë patur në lidhje me praktikat korruptive.


Figura 1: Presioni i korrupsionit dhe përfshirja në korrupsion



Referuar presionit të korrupsionit, rreth gjysma e të anketuarve (49.6 %) kanë pranuar se ju është kërkuar rryshfet në mënyrë direkte ose indirekte nga zyrtarët publik. Rezultatet e vitit 2016 tregojnë një përmirësim në krahasim me vitin 2001 dhe 2002, ndërsa një përkeqësim krahasuar me 2014. Të njëjtin trend, rezultojnë të ketë edhe përfshirja e qytetarëve në korrupsion, ku në vitin e fundit paraqitet një rritje e lehtë prej afërsisht me 1 përqind e numrit të të anketuarve që pranojnë se u kanë dhënë rryshfet zyrtarëve publike, krahasuar me 2014.


QENDRIMET NDAJ KORRUPSIONIT

Figura 2: Pranimi i korrupsionit




Në lidhje me ndaj korrupsionit, rezultatet e anketimit tregojnë se një në dy shqiptarë, janë tolerantë ndaj sjelljes së korrupsionit me një përkeqësim të lehtë (3%) krahasuar me 2014. Kjo tregon mungesën e besimit nga ana e shqiptarëve - që ka ardhur gjithmonë e më shumë në rënie ndër vite - për marrjen e shërbimeve publike pa i dhënë rryshfet zyrtarëve publikë.

Figura 3: Njohja (identifikimi) e praktikave korruptive më të zakonshme



Në lidhje me njohjen e modeleve korruptive, rezultatet e anketimit tregojnë se pjesa më e madhe e popullsisë nuk ka vështirësi në identifikimin/njohjen e modeleve korruptive të pranuar gjerësisht si sjelle korruptive. Niveli i njohjes së praktikave korruptive nga ana e shqiptarëve, ka ardhur në rritje, me një diferencë pozitive prej 2% krahasuar me vitin 2014.

Figura 4: Ndjeshmëria ndaj korrupsionit




Ndjeshmëria e plotë ndaj korrupsionit (dhënia dhe marrja e rryshfeteve njëkohësisht) ka rritje krahasuar me 2014. 2/3 e të anketuarve (66%) shprehën se kanë tendencën për të marrë dhe për të dhënë rryshfet. Qytetarët që janë pak a shumë të ndjeshëm, përfaqësojnë rreth 91 përqind të pjesës së popullsisë mbi 18 vjeç. Nga viti 2001 deri në vitin 2016, pjesa e të anketuarve që janë totalisht të pandjeshëm ndaj korrupsionit është rritur vetëm me 3%.

PERCEPTIMET E KORRUPSIONIT


Sipas rezultateve të anketimit, në vitin 2016 grupet që perceptohen si më të korruptuar janë gjyqtarët, doganierët, prokurorët, zyrtarët e administratës në sistemin e drejtësisë, partitë politike dhe liderat e koalicionit.

Figura 5: Perceptimet e korrupsionit për zyrtarët publik – më të korruptuarit



Gjyqtarët renditen si grupi më i korruptuar nga publiku i gjerë.

Figura 6: Perceptimet e korrupsionit për zyrtarët publik – më pak të korruptuarit



Ndërsa, grupet që perceptohen si më pak të korruptuar rezultojnë të jenë mësuesit, gazetarët, këshillat bashkiake dhe trupa pedagogjike e universiteteve.

Përsa i përket ndryshimit të korruptimit të zyrtarëve publikë, gjyqtarët mbeten njësoj të korruptuar si në vitin 2014. Asnjë përmirësim nuk është arritur në këtë drejtim. Raporti i fundit i Departamentit Amerikan të Shtetit, konfirmon si një ndër sfidat kryesore të Shqipërisë, nivelet shumë të larta të përhapjes së korrupsionit në sistemin e drejtësisë